



Datë 15.05.2026

A.nr. 1983/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 1983/2025, të datës 03.12.2025, të parashtruar nga ankuesi S.T nga Prishtina, në çështjen juridike – administrative “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 17 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 15.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1983/2025, e datës 03.12.2025, e parashtruar nga ankuesi S.T.

A r s y e t i m

Ankuesi S.T (*tutje referuar ankuesi*), përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net të datës 27.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 03.12.2025, kundër Vendimit me numër protokoll 3710 të datës 21.11.2024, të ushtrues të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale për emërimin e Komisionit Disiplinor, Vendimit me Nr. 041/I/2025 të datës 31.01.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e emërimit të Komisionit Disiplinor, Vendimit me Nr. 047/I/2025 të datës 07.02.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të emërimit të Komisionit Disiplinor, Vendimit me Nr. 352/X/2025 të datës 10.09.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për emërimin e Komisionit Disiplinor dhe Vendimit me Nr. 06/XI/2025 të datës 19.11.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale për shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Kosovës për Produkte Medicinale (*tutje referuar AKPM*), ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji i Këshilli duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e palejuar, sepse:

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton:

- Ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës ka qenë i punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit të Administratës, Financave dhe Buxhetit në AKPM.
- Ushtruesi i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv i AKPM-së, më datë 06.10.2025, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit më pretendimet së ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore.
- Komisioni Disiplinor i AKPM-së, më datë 19.11.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 06/XJ/2025, me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurës disiplinore të iniciuar ndaj ankuesit deri më datën 19.12.2025, ndërsa nuk ka dëshmi që Komisioni Disiplinor është mbledhur dhe rrjedhimisht nuk është nxjerr asnjë vendim lidhur me shqyrtimin e iniciimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Pretendimet ankimore

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin me numër protokolli 3710 të datës 21.11.2024, të ushtrues të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale për emërimin e Komisionit Disiplinor, Vendimin me Nr. 041/I/2025 të datës 31.01.2025, për ndryshimin dhe plotësimin e emërimit të Komisionit Disiplinor, Vendimin me Nr. 047/I/2025 të datës 07.02.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të emërimit të Komisionit Disiplinor, Vendimin me Nr. 352/X/2025 të datës 10.09.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për emërimin e Komisionit Disiplinor dhe Vendimin Nr. 06/XI/2025 të datës 19.11.2025 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale për shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës disiplinore, duke pretenduar se pozita e Kryeshefit Ekzekutiv të AKPM-së është në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë e konstatuar sipas Vendimit A.nr.1516/2025 të KPMSHCK-së, kështu që si rezultat i kësaj vendimet për emërimin e komisionit disiplinor dhe plotësim ndryshimi i vendimit janë të kundërligjshme. Kërkon pranimin e ankesës, shfuqizimin e vendimeve për formimin e komisioneve disiplinore, shfuqizimin e vendimit për shtyrje të afatit, pezullimin e çdo veprimi disiplinor deri në vendimin përfundimtar të KPMSHCK-së dhe konstatimin e paligjshmërisë absolute të procedurës disiplinore.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të çështjes, ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokolli 3710 të datës 21.11.2024, të ushtrues të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale është emëruar Komisioni Disiplinor për këtë institucion, mirëpo, me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, përbërja e Komisionit Disiplinor është ndryshuar dhe plotësuar sipas Vendimit me Nr. 041/I/2025 të datës 31.01.2025, Vendimit me Nr. 047/I/2025 të datës 07.02.2025 dhe Vendimit me Nr. 352/X/2025 të datës 10.09.2025, ndërsa, procedura disiplinore ndaj ankuesit është iniciuar më datë 06.10.2025, rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës, Komisioni Disiplinor sipas Vendimit me Nr. 352/X/2025 të datës 10.09.2025, ka ndërmarr veprimet juridike deri më datë 19.11.2025, ku me Vendimin me Nr. 06/XI/2025, ka bërë shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës disiplinore për rastin e ankuesit deri më datë 19.12.2025.

Tutje, sipas provave materiale të lëndës nuk ka prova që konstatojnë faktin nëse Komisioni Disiplinor i AKPM-së, ka vendosur lidhur me çështjen disiplinore të ankuesit të filluar sipas kërkesës së datës 06.10.2025, andaj, përderisa, ka kaluar afati fillestar për shqyrtimin e procedurës disiplinore prej 45 ditësh siç parashihet me dispozitat e nenit 13, paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civilë, si dhe afati i shtyrjes sipas Vendimit me Nr. 06/XI/2025, të datës 19.11.2025, atëherë, procedura disiplinore ndaj ankuesit konsiderohet e përfunduar pa masë disiplinore, kështu që, mbi këto rrethana ligjore Kolegji i Këshillit vlerëson se më aktet e kontestuar ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë apo interes nga marrëdhënies e punës.

Ndërsa, në kuptim të pranushmërisë së ankesës Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe nenit 124, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...”*, andaj, nisur nga konstatimet si më lart se ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës sepse aktet e kontestuar referuar emërimit të Komisionit Disiplinor si dhe plotësim/ndryshimit të anëtareve të Komisionit Disiplinor, janë veprime juridike të ndërmarra para inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, dhe duke qenë se nuk ka vendosje meritore lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, pra, nuk kemi veprim apo mosveprim të organit kompetent në raport me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës aktive në procedurë, kështu që, ankesa e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konsiderohet e papranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji”*.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1983/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit, S.T;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AKPM; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*